

DHJETOR 2016 - Ribotuar në prill 2018

Letër e hapur drejtuar emigrantëve njujorkezë

Mos ngurroni që të paraqiteni pranë mjekut, klinikës, spitalit ose urgjencës. Të gjithë emigrantët mund të marrin kujdes mjekësor në qytetin e Nju-Jorkut, pavarësisht statusit të emigrantit apo mundësisë për të paguar. Dëshirojmë që të mos ngurroni të kërkonit kujdes në çfarëdo ambienti.

“NYC Health + Hospitals” drejton spitalet publike dhe qendrat shëndetësore fqinje në qytetin e Nju-Jorkut. Ne ju respektojmë dhe dëshirojmë t’ju ndihmojmë në marrjen e kujdesit shëndetësor që meritoni. Kur vizitoni ambientet tona të kujdesit shëndetësor, ne nuk mbledhim informacion lidhur me statusin e emigrimit dhe nuk japim kurrë të dhëna të pacientit pa autorizimin e këtij të fundit ose pa kërkesë ligjore për ta bërë një veprim të tillë. Personeli ynë do të ruajë privatësinë dhe konfidencialitetin e të dhënave tuaja. Qendrat shëndetësore dhe spitalet tona janë krenare për historinë e gjatë të ofrimit të kujdesit për të gjithë individët. Përkushtimi ynë ka rrënjë të forta. Ai nuk ka ndryshuar.

Ne u premtojmë të gjithë emigrantëve:

QYTETI I NJU-JORKUT E KA POLITIKË MBROJTJEN E STATUSIT TË EMIGRIMIT DHE TË TË DHËNAVE TË TJERA KONFIDENCIALE. “NYC HEALTH + HOSPITALS” DO TA RESPEKTOJË TË DREJTËN TUAJ TË PRIVATËSISË.

Qendrat shëndetësore dhe spitalet publike të “NYC Health + Hospitals” gjenden në lagjet e të gjithë qytetit të Nju-Jorkut dhe ofrojnë shërbime në gjuhë të ndryshme. Ne ofrojmë shërbime përkthimi pa pagesë në 200 gjuhë, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, si dhe ofrojmë materiale të përkthyer për edukimin e pacientëve në 13 gjuhët më të preferuara nga pacientët tanë. Mjekët, infermierët dhe punonjësit tanë të tjerë të kujdesit shëndetësor shqetësohen për ju. Shumë prej tyre janë emigrantë ose fëmijë emigrantësh. Të gjithë ata dëshirojnë t’ju shërbejnë me respekt dhe do të bëjnë çmos që të mbrojnë privatësinë tuaj.

Disponohen mundësi të ndryshme për t’ju ndihmuar që të merrni kujdesin shëndetësor që ju nevojitet. Të gjithë fëmijët dhe femrat shtatzëna mund të përfitojnë sigurim shëndeti -- edhe nëse nuk keni status ligjor. Personeli i “NYC Health + Hospitals” mund t’ju ndihmojë që të merrni sigurimin që ju nevojitet. “NYC Health + Hospitals” do t’ju ndihmojë edhe nëse nuk keni sigurim

I VAZHDUESHËM ...



dhe nuk mund të paguani shuma të mëdha parash për kujdesin shëndetësor. Kjo vlen për të gjitha llojet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, përfshirë kujdesin në urgjencë, vizitat me mjekun, mjekimet, kujdesin afatgjatë dhe qëndrimet në spital. Për të mësuar shumën që mund të paguani, personeli ynë do t'ju kërkojë disa informacione në lidhje me të ardhurat që merrni dhe numrin e pjesëtarëve në familjen tuaj. Duhet të tregoni adresën e shtëpisë, një dokument identifikimi dhe datëlindjen tuaj. Ne dëshirojmë që ta merrni që sot kujdesin për të cilin keni nevojë, përpara se të sëmureni dhe përpara se të kthehet në një gjendje urgjente.


"NYC Health + Hospitals" ka lidhur gjithashtu një partneritet me "IDNYC", kartën e identifikimit komunal të qytetit të Nju-Jorkut, e disponueshme për të gjithë personat, e cila është një formë e pranuar identifikimi për pacientët dhe e cila mund të përdoret gjatë procesit të paraqitjes dhe regjistrimit.

Politika jonë është e qartë, punonjësit e "NYC Health + Hospitals" nuk mund t'ua japin të dhënat tuaja ASNJË PERSONI tjetër pa autorizimin e pacientit ose pa kërkesë ligjore për ta bërë një veprim të tillë. Të gjithë punonjësit tanë e dinë se nëse e shkelin këtë premtim, ata mund të humbin punën e tyre. Ne e kuptojmë që kjo është mënyra e vetme për të ruajtur besimin tuaj.

Për më tepër, ju ofrohen shërbime të tjera të qytetit të Nju-Jorkut, duke përfshirë ushqimin, arsimimin, shërbimet ligjore, sigurinë publike dhe të tjera. Ne i inkurajojmë emigrantët njujorkezë që të kërkojnë shërbimet e rëndësishme të qytetit të Nju-Jorkut që iu ofrohen atyre dhe familjeve të tyre.

Telefononi numrin 311 për listën e të gjitha qendrave shëndetësore dhe spitaleve publike, për të marrë më shumë informacione rreth burimeve si "IDNYC" ose për t'i dërguar një mesazh "NYC Health + Hospitals" apo Zyrës së Kryebashkiakut për Çështjet e Emigrantëve (Mayor's Office of Immigrant Affairs).

Misioni ynë është t'i japim mundësinë çdo njujorkezi – pa përjashtim – që të jetojë jetën e tij më të shëndetshme të mundshme.



Dr. Mitchell Katz

President dhe Drejtor Ekzekutiv
NYC Health + Hospitals



NISHA AGARWAL

Komisionar
Zyra e Kryebashkiakut për Çështjet e Emigrantëve



#NYCHealth4All

www.nychealthandhospitals.org

